



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

V E N D I M

PËR KTHIMIN PËR PLOTËSIM TË LISTËS SHUMEMËRORE TË KANDIDATËVE PËR ANËTARË NË KËSHILLIN E BASHKISË KAMËZ, TË DEPOZITUARA NGA PARTIA "ALEANCA DEMOKRATIKE" PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30 QERSHOR 2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 18.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për kthim për plotësim të listës shumemërore të kandidatëve për anëtar në Këshillin e Bashkisë Kamëz, të paraqitura nga Partia "Aleanca Demokratike", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa a, neni 67, neni 72 dhe neni 73, pika 1, të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë"

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Partia "Aleanca Demokratike", si dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

V Ë R E N:

Partia "Aleanca Demokratike", është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.



Nr. 530 i Vendimit

Data 18.05.2019

Ora 12:00 e Vendimit

Për kthimin për plotësim të listës shumemërore të Partisë "Aleanca Demokratike", zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019

Në bazë të nenit 67 dhe nenit 72, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Partia "Aleanca Demokratike" ka paraqitur në KQZ dokumentacionin për miratimin e listave shumemërore.

Në mbledhjen e datës 12.05.2019 në bazë të nenit 73, të Kodit Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve verifikoi listat shumemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak të Partisë "Aleanca Demokratike" dhe dokumentacionin bashkëngjitur të paraqitur dhe konstatoi mangësitë e dokumentacionit si më poshtë:

1. Dokumenti identifikimit dhe deklaratat e kandidatëve të listës shumemërore.

Në këto kushte KQZ duhet:

Të kthej për plotësim dokumentacionin e kandidimit, për korrigjimin e mangësive të konstatuara, nga Partia "Aleanca Demokratike".

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbështetur në nenin 23, pika 1, gërma a, nenin 67, pikat 1, 4, 5, dhe 6, nenin 72, dhe nenin 73, pika 1 të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

V E N D O S I:

1. Kthimin për plotësim të dokumentacionit për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për anëtarë Këshilli të Bashkisë Kamëz, të Partisë "Aleanca Demokratike", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare



Nr. 530 i Vendimit

Data 18.05.2019

Ora 12:00 e Vendimit

Për kthimin për plotësim të listës shumemërore të Partisë "Aleanca Demokratike", zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019